

Transcription as process and the case study of Taqi (Dhimitër) Deliana.

Abstract: *This article is focused on the process of transcription taking cue from a particular case-study: the transcription of a tape-recorded conversation led by the ethnomusicologist Hysen Filja with the former byzantine chanter, Taqi Deliana, dating from 1977, treasured in the Audiovisual Archive of the Institute of Anthropology (Former Institute of Cultural Anthropology and Art Studies). Centred around the Byzantine music practices in the Kala neighbourhood in Elbasan, such conversation is a subject matter rather exceptional for that period. In fact, Albania had proclaimed itself an atheist country just a few months earlier and any form of religious activity was severely punished by the penal code. Thus, the process of turning this aural-oral conversation into a written text brings along many implications which need a thorough consideration of the meaning of transcription as method and cultural product. Such implications have never undergone any critical revision by scholars, although transcription has been a very popular method. Driving on a number of scholarly contributions regarding transcriptions (such as Elinor Ochs, Alessandro Duranti, Mary Bucholz), the process of transcription is being revised both on theoretical and interpretive levels.*

Keywords: *transcription, Byzantine chant, Elbasan, Albanian communism, ethnomusicology, cultural product.*

I. Hyrje

Në periudhën maj-qershor të vitit 1977, Hysen Filja, etnomuzikolog, studiues në Institutin e Folklorit zhvilloi ekspeditën e radhës në Elbasan. Çdo vit, studiuesit e këtij Instituti bënë ekspedita në terren, me qëllim mbledhjen e materialeve të ndryshme në formë “artefakti tingullor”¹. Ky

1 Hulumtimi i kësaj ekspedite është bërë në kuadër të një projekti kërkimor mbi trashëgiminë tingullore të qytetit të Elbasanit, mbledhur përmes një serie ekspeditash etnomuzikologjike, zhvilluar gjatë periudhës 1960-1990. Për më shumë shih: M. Minga, *Tinguj që rrëfejnë, tinguj që rrëfehen – Elbasani në regjistrimet etnomuzikologjike të arkivit audiovizual – IAKSA, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2020.*

material ruhej më pas në arkiv. Për dekadën në fjalë, kjo është ekspedita e vetme në këtë zonë, në ndryshim nga dy dekadat paraardhëse dhe pasardhëse, që ishin më të shpeshta. Gjithsesi, nga këto ekspedita, kjo e vitit 1977 veçohet edhe për disa arsye specifike:

Së pari, për larminë e materialeve. Krahas tipologjisë muzikore që është tipike për zonën, kësaj here regjistrohen edhe këngë me çifteli, këngë polifonike, si dhe këngë të “folklorit të ri”. Janë interpretime nga punëtorë të ardhur nga vende të tjera dhe të vendosur me punë në Kombinatin Metalurgjik, dëshmi kjo e ndryshimit të peizazhit tingullor urban nën zhvillimet industriale². Së dyti, kemi të bëjmë me një qasje më specifike ndaj terrenit nga ana e Hysen Filjes. Synimit parësor për të mbledhur artefakte tingullore e për të pasuruar arkivin - si ishte përgjithësisht programi i punës së punonjësve të Insitutit të Folklorit - Filja i vendos edhe një të dytë, të lidhur drejtpërdrejt me punën kërkimore të tij mbi muzikën popullore të Shqipërisë së Mesme. Kjo punë do të botohet në formën e një vëllimi me transkriptime muzikore të prejardhura nga arkivi tingullor dhe të pajisura me një parathënie shpjeguese³.

Në këtë kontekst, ai zhvillon edhe një bisedë me Taqi Delianën, më datë 25 qershor 1977, e cila sjell një thyerje në metodologjinë e punës së deritanishme mbledhëse të artefakteve tingullore. Në arkiv, ajo është e emërtuar si “Bisedë me Taqi Delianën” dhe klasifikohet në tipologjinë e “prozë-bisedës”, me numër bobine 18668-1297-01. “Biseda” të tilla mes studiuesit dhe bartësit nuk janë fort të shpeshta në punën e kryer nga etnomuzikologët dhe folkloristët e Institutit të Folklorit. Ndonëse në Arkivin Audiovizual numërohen disa të tilla, këto janë një pakicë krahasuar me artefaktet tingullore. Për sa i takon gjeografisë së Elbasanit, për periudhën e sipërpërmendur, kjo është e vetmja e tillë. Megjithatë, ajo që shenjon akoma më shumë veçanësinë e saj është tematika fetare që trajton. Biseda shtjellohet mbi praktikën muzikore bizantine të lagjes Kala dhe Taqi Deliana kishte qenë psallt i kishës së kësaj lagjeje.

Duke marrë parasysh rrethanat, mund të themi se kjo bisedë zhvillohet në kushtet e të jashtëzakonshmes. Ka rreth 10 vjet që praktikën fetare janë ndaluar. Shqipëria është shpallur vend ateist me Kushtetutën e vitit 1976 dhe, jo më larg se 10 ditë para se të zhvillohet biseda në fjalë, kishte hyrë në fuqi Kodi Penal, i cili dënonte me burg veprimtaritë e lidhura me fenë, duke përfshirë edhe mbajtjen e literaturës përkatëse.⁴

2 *Ibid.*, 124-127.

3 H. Filja, *Këngë popullore të Shqipërisë së mesme*, Akademia e Shkencave e RPS, Tiranë, 1991.

4 Kodi Penal i RPSSH-së, dt. 15.06.1977. Neni 55: Agjitacioni e propaganda kundër shtetit. Sipas këtij neni “përgatitja, përhapja ose ruajtja për përhapje e literaturës me përmbajtje të tillë për të dobësuar ose minuar shtetin e diktaturës së proletarietit,

Për biografinë e Delianës i referohemi atyre pak të dhënave që na jep dokumenti arkivor, skeda shoqëruese, si dhe informacioneve që marrim në mënyrë empirike përmes të birit të tij Rudolf Deljanës⁵. Prej tyre, ndërtojmë profilin e një njeriu jo vetëm *politically incorrect* për kohën, por edhe të skajuar. Dhimitër, ose Taqi Deliana, si thirrej zakonisht nga familjarët e të njohurit, kishte lindur diku rreth vitit 1886-1887, në Lagjen Kala. Ishte djali i priftit të Kishës së Shën Marisë, të njohur në komunitet si Papa Venemin (Veniamin) Deliana (1848-1920). I ati kishte qenë një figurë e njohur në qytet, gjë që vinte për shkak të statusit klerikal në një hapësirë urbane që orientohej nga organizimi fetar i komuniteteve, por edhe si rrjedhojë e aktivizimit të tij në mbështetje të gjuhës shqipe në dekadat e para të shekullit XX. Familja Deliana i përkiste shtresës së mesme, të shkolluar. Gjatë gjysmës së parë të shekullit XX, shohim që shumë pjesëtarë të saj u integruan në elitat intelektuale të kohës, duke u angazhuar edhe politikisht. Djali tjetër i Taqi Delianës, Venemini ishte pjesë e Ballit Kombëtar, arsye për të cilën emigroi në vitin 1944 dhe jetoi jashtë Shqipërisë. Ky ishte një faktor përcaktues për statusin e familjes së ngelur në Elbasan dhe jetët e anëtarëve të tjerë të familjes gjatë diktaturës⁶.

I biri tregon se Deliana kishte mbaruar shkollën greke të Kalasë, duke përvetësuar në nivele të mira gjuhën greke. Ndërkaq, disa detaje gjatë bisedës që Filja kishte bërë me të sugjerojnë që ai e njihte mirë edhe osmanishten e kohës. Fillimisht, mësoi zanatin e rrobaqepësit, të cilin edhe e ushtroi për ca kohë. Ishte sekretar i shoqërisë “Afërdita” të themeluar më 1909⁷. Në vitin 1923, në kuadër të krijimit të gjendjes civile, ndoqi një kurs disajavor në Tiranë dhe pas kësaj punoi si ofiqar i gjendjes civile; fillimisht në disa komuna dhe, më pas, në bashkinë e Elbasanit. Në vitin 1944 e pushuan nga puna si nëpunës dhe prej atij momenti nuk punoi më. I biri tregon se iu refuzua edhe e drejta e pensionit, çka kishte të bënte pikërisht me qëndrimet politike të anëtarëve të familjes. Punoi si psallt në Kishën e Shën Mërisë, në Lagjen Kala, punë që i siguronte një lloj të ardhure modeste deri në mbylljen e saj.⁸

dënohet: me heqje të lirisë nga tre gjer në dhjetë vjet.” Ndërsa Kushtetuta e RPSSH-së, dt. 28.12.1976 shpallte mosnjohjen e asnjë feje nga shteti dhe zhvillimin e propagandës ateiste.

- 5 Rudolf Deliana (1931-2024) ka qenë mësues dhe drejtues, për një kohë të gjatë, i shoqatës “Normalisti”, në Elbasan, shoqatë që merret me promovimin e trashëgimisë së Normales së Elbasanit. Ka botuar edhe një monografi kushtuar figurës së Vasil Andonit (1902-1994), pinjoll i familjes Deliana dhe kushëri i tij, në të cilën flet gjerësisht edhe për historikun e familjes Deliana. Ndërroi jetë në shkurt të këtij viti.
- 6 R. Deliana dhe R. Deljana, *Vasil Andoni*, Instituti Lumo Skendo, Tiranë, 2018, 117.
- 7 K. Bevapi, *Shoqëria ‘Afërdita’*, në K. Bevapi (përg.) *Elbasani Enciklopedi*, Sejko, Elbasan, 2003, 558-559.
- 8 Nga të dhënat arkivore, në vitet ‘60 rezulton që Deliana është paguar me një rrogë

Në momentin e regjistrimit Taqi Deliana ishte thuhet 90 vjeç. Do të ndërronte jetë një vit më vonë, në vitin 1978.

Në fakt, ekzistencën e këtij dokumenti kaq të përveçëm për kohën e evidenton më herët studiuesi Eno Koço, në një studim dy gjuhësh (anglisht dhe shqip) rreth isos vokale.

«Psalti Taqi Deljana nga Elbasani diti të mbijetojë kryesisht falë maturisë së tij. Pata fatin të më bjerë në dorë një regjistrim i rrallë në shirit magnetofoni i bërë nga ai më 26 qershor 1977. E quaj të rrallë dhe të çmuar për dy arsye: së pari, sepse feja, veçanërisht gjatë viteve 1970, ishte rreptësisht e ndaluar në Shqipëri dhe se një intervistë e tillë me subjekt fetar do të ishte shkelje e qartë e normave të ideologjisë komuniste; së dyti, psalti Deljana ishte në atë kohë 90 vjeç dhe fatmirësisht me shëndet të mirë që të mund të fliste qartë e të këndonte. Gjithashtu, vlen të çmohet nisma e muzikologut Albert Paparisto, që duke qenë vetë nga Elbasani, i dha shtysë kësaj interviste për sa kohë që psalt Deljana ishte ende gjallë, duke bërë të mundur fiksimin në shirit të njohurive të tij mbi ritet bizantine. Paparisto me kurajë organizoi takimin me psalt Deljanën me justifikimin se intervista do të shërbente vetëm për qëllime arkivore. Ai rekomandoi Hysen Filen, një tjetër muzikolog shqiptar, të cilit iu besua detyra të zhvillonte intervistën. Prejardhja muslimane e Hysenit mund të ketë ndihmuar intervistën, por kuraja dhe dëshira e tij e mirë ishin edhe më të nevojshme për të përmbushur detyrën.»⁹

Ndonëse Koço nuk e specifikon burimin prej nga e ka marrë këtë intervistë dhe përcakton si datë 26 qershorin, analiza që i bën materialit dhe detajet e përmbajtjes sugjerojnë se bëhet fjalë për të njëjtin material. Por, matanë pasaktësisë së datës, janë disa interpretime të tijat të cilat duhen marrë me rezervë, si do të vërehet më poshtë.

Këtë prozë-bisedë e kam trajtuar në mënyrë të përveçme në studimin tim monografik.¹⁰ Megjithatë, e shoh të udhës ta rimarr sërish si rast specifik, duke zgjeruar një seri aspektesh teorike dhe metodologjike rreth punës me dokumentin arkivor dhe, mbi të gjitha, me transkriptimin si *proces*.¹¹ Biseda me Delianën shërben si një *rast studimi* në këtë drejtim,

mujore për punën si psallt. Shih: M. Kumbe, *The psaltic art in Albania from the beginning of the 20th century until today*, Tezë doktorature. Universiteti Kombëtar "Kapodistria" i Athinës, Dega e Studimeve Muzikore, Athinë, 2018, 155.

9 E. Koço, *Udhëtim i isos vokale/A journey of the vocal ison*, Neraida, Tiranë, 2014, 152.

10 M. Minga, *Tinguj që rrëfejnë*, 199-215.

11 E. Ochs, *Transcription as theory*, në E. Ochs & B. Schieffelin (përg.) *Developmental pragmatics*, Academic, New York, 1979, 43-72.

rast i cili mund të vendoset brenda një perspektive më të gjerë në të cilën po shkelin kërkimet etnomuzikologjike në Shqipëri.

II. Transkriptimi si praktikë dhe produkt kulturor

Një vëmendje e tillë ndaj transkriptimit e ka prejardhjen nga e njëjta kornizë teorike, e cila përfshiu gjithë korpusin e regjistrimeve të Elbasanit. Kjo kornizë merr parasysh së pari, punën *dëgjimore*, ku të dëgjuarit përfaqëson një akt të qëllimshëm dhe të mbrujtur me forcë kritike, i cili lidhet qoftë me dokumentin në vetvete, ashtu edhe me dijen etnomuzikologjike, etnografike e folklorike të kohës kur ky dokument u krijua¹². Së dyti, si një ndërthurje epistemike mes aurales dhe vizuales, ku merr rëndësi jo vetëm si ndodh regjistrimi i të dhënave në një medium të caktuar (inscription) dhe shkrimi i tingujve që dëgjohen, por edhe çfarë përfaqëson një gjë e tillë në transmetimin dhe interpretimin e tyre. Si rrjedhojë, nuk do të mund t'i shpëtonte lentes shqyrtuese as puna e kujdesshme transkriptuese, për ta shndërruar këtë regjistrim tingullor në një "tekst" (të shkruar në letër) i cili më pas mund të analizohet, shqyrtohet, interpretohet dhe që lidhet me fenomenin tingullor prej të cilit vjen.¹³

Transkriptimi në notë ka qenë pjesë e thelbësore e objektit të studimit së etnomuzikologjisë në përgjithësi të paktën deri në fillim të viteve '80-të, kur kemi "kthesën interpretative".¹⁴ Ndërkaq, etnomuzikologjia në Shqipëri u mbështet gjerësisht mbi këtë metodë përgjatë gjithë periudhës totalitare. Megjithatë, praktika ngeli brenda një rrafshi mekanik, pa mundur të prodhojë një kornizë teorike rreth metodologjive të përdorura si dhe implikimeve që ka shndërrimi i një dukurie aurale-orale në të shkruar në letër.¹⁵ Kohët e fundit vërejmë një "kthesë" në këtë drejtim: Së pari, duke

12 Shih për këto: P. Szendy, *Listen: A history of our ears*, Fordham University Press, New York, 2008, 34; V. Erlmann, *Hearing cultures. Essay on sound, listening and modernity*, Berg, Oxford; New York: 2004; V. Erlmann, *Reason and resonance: A history of modern aurality*, Zone Books, New York, 2010; M. Ochoa Gautier, *Aurality: Listening and knowledge in nineteenth century Colombia*, Duke University Press Durham, NC 2014; R. Bauman, Ch. L. Briggs, *Voices of Modernity. Language Ideologies and the Politics of Inequality*, Cambridge University Press, New York, 2003; N. Bardhoshi, O. Lelaj, *Etnografi në diktaturë: Dija, shteti dhe holokausti ynë*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2018.

13 A. Duranti, *Transcripts, like shadows on a wall*, "Mind, culture, and activity" 13/4 (2006), 301. Shih edhe T. Shgold, *Lines: A Brief History*, Routledge, London, 2007. Përmes analogjisë dhe metaforës së rreshtit (line), ai shqyrton thelbet gjuhës, muzikës dhe notacionit si pjesë e narrativës, performances, dhe regjistrimit (inscription) në një medium të caktuar.

14 T. Rice, *Ethnomusicological theory*, "Yearbook for traditional music" 42 (2010), 100-134. Shih edhe T. Rice, *Modeling ethnomusicology*, Oxford University Press, Oxford, 2017.

15 M. Minga, *Tinguj që rrëfejnë*, 78-84.

nxitur një perspektivë kritike ndaj kësaj metodologjie pune si pjesë e dijes etnomuzikologjike gjatë periudhës diktatoriale. Së dyti, duke e përdorur transkriptimin brenda kuadrit të një pune filologjike sa i takon rindërtimit të një repertori të caktuar (në këtë rast, atë të ahengut shkodran) dhe përmbylljes së ciklit të dokumentimit të tij.¹⁶ Kësisoj teksti i notizuar mund t'i shërbejë thellimit analitik, por edhe një ri-interpretimi muzikor të mundshëm, duke nisur prej tij.¹⁷ Krahas punës individuale, transkriptimi ishte pjesë e punës me projektin kërkimor “Atlasi etnografi i fshatit sot” - 2020-2022, në të cilin u angazhuan studiuesit e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, përmes një cikli ekspeditash në terren që kishin në fokus mbledhjen e të dhënave etnografike mbi fshatin shqiptar sot. Metoda kryesore e përdorur ishte ajo e bisedave dhe intervistave gjysëm të strukturuar, të bazuara mbi një pyetësor paraprak. Kjo metodë rezultoi efektive edhe në mbledhjen e informacioneve e të dhënave të shumta gojore mbi praktikën muzikore të së shkuarës dhe të tashmës të fshatit shqiptar.¹⁸

Transkriptimi i tingullit në pentagram dhe ai i ligjëratës së folur në të shkruar mund të kenë shumë tipare të përbashkëta, sikundër dallohen nga njëri tjetri për një sërë arsyes që nuk kanë të bëjnë edhe aq me sistemet përkatëse konvencionale të transkriptimit, sa me kuadrin hermeneutik. Nga kjo pikëpamje, transkriptimi i një ligjërate të folur dhe të regjistruar në një variant të shkruar mbart sfidat e veta brenda kërkimit etnomuzikologjik. Megjithatë ai ka rëndësinë e vet kur vjen rasti për të hulumtuar muzikën jo si një fenomen tingullor i izoluar, por si një aktivitet human i cili është pjesë e një konteksti të caktuar muzikëbërjeje. Rasti i Delianës shërbën si piketë për të reflektuar. Për këtë, e shoh me vend që t'i drejtohem antropologjisë me fokus gjuhësinë, si një nga fushat që është marrë më drejtpërdrejt me studimin e kësaj praktike.

Kësaj rëndësie të tejshkrimit të ligjëratës së folur brenda etnomuzikologjisë do t'i shtoja edhe një nivel tjetër. Krahas transkriptimit akademik, si metodë kërkimi në disiplina të ndryshme shkencore, po aq e pranishme është kjo metodologji pune edhe në botën e publicistikës dhe gazetarisë. Kontakti i shpeshtë në kuadër të promovimit dhe bërjes të njohur të punës shkencore për një audiencë më të gjerë, ka nxjerrë në pah qasjen e përcipte ndaj këtij procesi, pavarësisht aplikimit të gjerë të tij. Ndodh që gazetarë

16 E. Ballgjati, *Ahengu shkodran. Notizim i plotë*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2021.

17 *Ibid.*, 19.

18 Për një informacion të përgjithshëm shih: E. Kaçi, *Projekti kërkimor: Atlasi etnografik i fshatit sot. “Antropologji”* 5/1 (2022), 133-136. <https://albanica.al/antropologji/article/view/762/755> (konsultuar për herë të fundit më 20 shkurt 2024) http://iaksa.edu.al/wp-content/uploads/2023/01/Antropologji_vol.-5_no.-1_2022-2.pdf (konsultuar për herë të fundit më 24 janar 2023).

nisin paraprakisht pyetjet për intervistë, me kërkesën për t'i regjistruar përgjigjet në audio (ose edhe video) përmes celularit, për t'ua ridërguar sërish nëpërmjet postës ose medimeve elektronike. Këtë “tekst” gazetari/ja e “zbardh” dhe e boton. Por, produkti i prejardhur nga kjo “zbardhje” e pretenduar, diktohet nga zgjedhje të caktuara të personit: Në disa raste ruhet struktura klasike e intervistës me pyetje-përgjigje, kurse në të tjera, autori/ja shkon drejt një varianti rrëfimtar, ku pyetjet shkrihen brenda ligjëratës së zhdrejtë. Akoma më i mprehtë ky lloj kriteri përzgjedhës është në rastet kur gazetari/ja transkripton vetëm copëza të caktuara nga një bisedë, apo ligjëratë e folur publike, e cila në variantin e shkruar, vjen si “citim” brenda një reportazhi mbi ngjarjen e ndodhur. Kësaj here fraza jo vetëm që shkëputet nga konteksti i plotë, por, në disa raste, mund të lërë hapësirë edhe për keqkuptime.

Në fjalorin e gjuhës shqipe, transkriptimi paraqitet si një proces relativisht neutral. Kemi të bëjmë me një pune teknike në të cilin “shënohen tingujt e folur duke përdorur shenja të veçanta”.¹⁹ “Zbardh” haset gjithashtu në përdorim, për të treguar procesin e hedhjes në letër të një diskursi të folur si nxjerrje të dhënash, ndonëse kuptimi që jep fjalori lidhet me rishkrimin qartë të diçkaje të shkruar më përpara jo qartë, pra rishkrim; hedhje në të pastër.²⁰ Kuptimi i zbardhjes këtu na çon tek ai “favorizim” tipik zotërues i vizuales, në raport me auralen/tingulloren; e shkruara që qartëson dhe “rregullon” të folurën sipas sistemit të saj konvencional, duke e bërë të lexueshëm. Mirëpo, të gjitha rastet tregojnë se përfaqësimi i një akti të folur në letër nuk është një proces mekanik, por implikon zgjedhje të caktuara për të cilat duhet reflektuar.

Kontributi i parë dhe më i rëndësishëm lidhur me transkriptimin është ai Elinor Ochs, e cila përpiket edhe të ndërgjegjësojë mbi çështjen. Për Ochs-in, transkriptimi është *proces* përzgjedhës, i cili pasqyron qëllime të caktuara teorike dhe përcaktime specifike.²¹ Kontributi i saj ka qenë pikë referimi për studimet vijuese të cilat janë orientuar tek shumësia e konvencioneve të transkriptimit dhe negocimi i tyre në varësi të kontekstit. Krahas kësaj, interesi studimor ka përfshirë edhe përcaktimin e një kuadri teorik e interpretativ për transkriptimin.²² Nga këto, do të veçoja analizën e Alessandro Duranti-t për ta konsideruar transkriptimin si një *praktikë*

19 Kuptimet e tjera kanë të bëjnë me kthimin në shkrimin e sotëm, një tekst me shkronja të tjera dhe përshtatjen e një vepre muzikore për një vegël a një zë tjetër. *Fjalori i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2006, 1099 -1100

20 *Ibid.*, fq. 1216.

21 E. Ochs, *Transcription as theory*, 44.

22 Për më shumë informacion bibliografik shih: J. H. Stelma dhe L. J. Cameron, *Intonation units in spoken interaction: Developing transcription skills*, “Text & Talk” 27/3 (2007), 361-365; M. Bucholz, *The politics of transcription*, “Journal of Pragmatics” 32, (2000), 1440.

kulturore e cila mund të bëjë vetëm një përfaqësim të pjesshëm të ngjarjes dhe jo të japë totalitetin e saj.²³ Për më tepër, duhet të kemi parasysh që edhe kjo e pjesshme vjen si një e dhënë e mediatizuar, pra e ndërmjetësuar përmes regjistrimit tingullor, apo audiovizual. Për Duranti-n, transkriptimi është një artefakt i cili ka përmasën e vet temporale-historike: ai është i orientuar nga e shkuara, si dokument historik dhe gjithashtu nga e ardhmja, duke qenë në gjendje që të ri-aktivizojë veçori të cilat janë kapur prej tij.²⁴ Kur kemi të bëjmë me regjistrime tingullore apo audiovizuale, ai fton të mos biem pre e keqkuptimit virtual-realist, që privilegjon të dhënë e regjistruar si kapje të plotë të ngjarjes dhe as të atij hiperkontekstualist, që i jep të drejtë përvojës së drejtpërdrejtë, si vëzhgues-pjesëmarrës, por neglizhon faktin se edhe kjo prani ndikon në mënyrën si formësohet ngjarja që regjistrohet. Në vend të kësaj, ai sugjeron që «të tematizohet, marrëdhënia mes regjistrimeve dhe ngjarjeve për të cilat ato japin informacion dhe gjithashtu, marrëdhënia mes regjistrimeve dhe transkriptit»²⁵.

Duranti nxjerr në pah gjithashtu që transkriptimet kanë një jetë të tyre, ose, më mirë, ne ju japim jetë atyre: lindin, pasurohen, korrigjohen, ndryshohen, shpesh duke i mbajtur gjatë në dorë, ose duke i lënë në sirtar për disa vite. Dhe kjo nuk do të thotë që versionet e mëparshme ishin të gabuara; më shumë kjo është tregues sesi ndryshon interesi i transkriptuesit dhe gjithashtu, si lëviz kuadri epistemologjik e teorik ndaj këtyre të dhënave.²⁶

Ndërsa Mary Bucholz, që, ashtu si Duranti, inkadrohet brenda linjës refleksive të mendimit antropologjik dhe sociologjik, nxjerr në pah edhe përmasën politike të transkriptimit, duke theksuar se nuk kemi të bëjmë me produkte tekstuale transparente, por me dokumente që mbartin ngarkesën e vet politike në të cilën edhe kërkuesi është tërësisht i përfshirë. Transkriptimi është një proces që ka të bëjë me: zgjedhje e vendime të caktuara interpretative (çfarë transkriptonet?) dhe, po ashtu, me zgjedhje përfaqësimi (si është kryer ky transkriptim?). Vendime dhe zgjedhjet e bëra nga transkriptuesi i përgjigjen kontekstit në të cilin ndodh transkriptimi, çka përfshin pritshmëritë dhe bindjet e transkriptuesit rreth folësit dhe ndërveprimin që transkriptonet; po ashtu audiencën dhe qëllimet që ka autori në raport me tekstin e transkriptuar.²⁷

23 A. Duranti, *Transcripts, like shadows on a wall*, 301-310.

24 *Ibid.*, 302.

25 *Ibid.*, 309.

26 *Ibid.*, 307

27 Audiencë këtu përdoret në kuadrin letrar, për të identifikuar atë grup njerëzish që shkrimtari ka parasysh kur shkruan një vepër të caktuar. M. Bucholz, *The politics of transcription*, 1439-1465. Shih edhe: A. Jaffe, *Variability in transcription and the complexities of representation, authority and voice*, "Discourse Studies" 9/6 (2007), 831-836.

III. Bisedë me Taqi Delianën: Nga teksti tingullor në tekstin e shkruar

Këtu synoj të ndjek sugjerimin e mësipërm të Alessandro Duranti-t mbi tematizimin në transkriptim; pra, duke tematizuar marrëdhënien mes regjistrimeve dhe ngjarjeve për të cilat ato japin informacion dhe gjithashtu lidhjen mes regjistrimeve dhe transkriptit.

E dhëna arkivore e Prozë-bisedës me Taqi Delianën përbëhet nga shirit i regjistruar e i digjitalizuar dhe skeda bashkëshoqëruese. Nuk është gjetur asnjë variant transkriptimi i kësaj bisede të kryer nga Hysen Filja. Po ashtu, nuk zotërojmë ndonjë informacion specifik për mënyrën si mund të ketë përdorur Filja këtë burim dokumentar. Ai nuk ka shkruar mbi këtë temë konkretisht për të shprehur mendimet e tij. Për këtë arsye, puna e parë e domosdoshme për studimin e këtij dokumenti ishte transkriptimi. Një transkriptim i parë u bë në kuadër të projektit monografik dhe u karakterizua nga disa etapa: së pari, vlera njohëse, për të qartësuar e marrë informacionin e mundshëm rreth Taqi Delianës dhe arsyeve që e shtynë Hysen Filjen për ta bërë një gjë të tillë. Në këtë fazë, transkriptimi ishte në funksion të kapjes sa më të plotë të asaj që dëgjohej. Praktikiteti teknologjik e mundësonte një gjë të tillë. Teksti i shkruar ishte rezultat i disa seancave dëgjimore të cilat, në momentin që arritën të riprodhonin në letër një kuadër relativisht të plotë të kësaj përvoje, i dhanë shtysë qëllimit të dytë për ta shqyrtuar këtë dokument tingullor në lentën e pushtetit të studiuesit, të arkivit si entitet ruajtës dhe mënyrës si zhvillohet ky tension nga biseda, te dokumenti audio, deri te produkti që studiuesi mund të nxirrte ose jo prej tij. Për ta realizuar këtë, nga “teksti” i shkruar u segmentuan disa momente specifike, të cilat e nxirrnin më posaçërisht në pah një gjë të tillë.²⁸

Gjatë punës transkriptuese u përpoqa fillimisht t’i qëndroja metodologjisë së «transkriptimit të natyralizuar». Ky i jep përparësi diskursit të shkruar përkundrejt atij oral, duke ia nënshtruar këtë të fundit “diktatit” të letraritetit; çka nënkupton një lloj literacizimi (literacization) të ligjëratës së folur në të shkruar.²⁹ Megjithatë, jo gjithmonë ishte e mundur që të realizohej një gjë e tillë, sidomos në rastet kur Taqi Delianës i duhej të sforcohej për të kujtuar diçka dhe, si rrjedhojë, artikulohej me copëza mendimi të pastrukturuar në mënyrë të rregullt nga ana sintaksore. Për këtë, «transkriptimi i denatyralizuar»³⁰, në të cilin teksti i përmbahet kodeve të gjuhës së folur m’u duk më i përshtatshëm, duke qenë e kujdesshme që, në momentin e leximit të tekstit të shkruar, të ruhet sensi logjik i mendimit, për ata që e konsultojnë pa ndërmjetësinë e dokumentit tingullor. Procesi synonte të merrte parasysh qoftë aspektet fonetike/dialektologjike, ashtu

28 Shih: M. Minga, *Tinguj që rrëfejnë*, 199-215.

29 M. Bucholz, *The politics of transcription*, 1461.

30 *Ibid.*, 1461.

edhe ato të organizimit sintaksor. Por, matanë këtyre detajeve, i gjithë procesi karakterizohej nga qasja e Bucholz-it, sipas së cilës, «transkriptimi mbetet pazgjidhshmërisht një akt krijues e autorial.»³¹

Për këtë, u përpiluan shënimet shpjeguese si më poshtë:

- [] Shënime të transkriptuesit vendosur mes kllapave katrore
 - (.) Pushim/heshtje gjatë bisedës.
 - < > Transkriptim jo plotësisht i sigurt.
 - <...> Biseda ose fjalë që nuk perceptohen qartë në dëgjim.
- Në rastet kur mendimi nuk përmbillet, është vendosur presje.
Momentet e kënduara, teksti shënohet me kursiv.

Emrat e pjesëmarrësve janë shënuar me inicialet e tyre:

- HF: Hysen Filja
- TD: Taqi Deliana
- SM: Stefan Marku
- MD: Miranda Dule
- MSH: Met Shkëmbi

Etapë e parë e këtij transkriptimi ishte e ndërruar nga dokumenti tingullor, një variant i të cilit po regjistrohej në letër. Kur iu riktheva sërish tekstit të shkruar, duke pasur synim transkriptimin si proces, ajo që ishte e qartë qysh në krye të herës ishte prania e dy produkteve të ndërlidhur, por të ndryshëm: një “tekst” tingullor nga njëra anë dhe një tekst i shkruar nga ana tjetër, i prejardhur, si e theksova më sipër, «nga një akt krijues, autorial».

Për këtë, u punua me më shumë kujdes në drejtim të gjetjes së një ekuilibri mes formatit të natyralizuar dhe atij të denatyrizuar. U punua mbi të njëjtin tekst, duke u bërë shtesa, qartësime fjalësh të cilat nuk ishin kapur me dëgjimet e mëparshme. Familjarizimi me zërat, me atë që ndodhte në bisedë, ndihmoi në kapjen e një “fjalori” specifik që Deliana përdorte kur fliste rreth artit psalltik. E tija, ndonëse nuk është një dije sistematike mbi muzikën bizantine, por një përvojë e mësuar në trajtë aurale, përmes dëgjimit dhe praktikës, ka një vlerë të përveçme për të njohur mënyrën si artikullohet ajo tek figura e një psallti qytetës, gjatë shekullit XX, deri në momentin kur u ndaluan praktikat fetare. Deliana e shtron bisedën me mençuri dhe arrin të qartësojë bashkëbiseduesit mbi mënyrën si kultura bizantine ruajti karakteristikat e saj që kishte të bënte me natyrën vokale të muzikës. Kjo natyrë vokale, sipas tij, pati si protagonist kryesor figurën e psalltit. Pra, ai evidenton karakteristikën më të rëndësishme të praktikave muzikore bizantine, e cila ka të bëjë me artin e të kënduarit psalltik.

31 *Ibid.*, 1461.

Këtu po sjell disa fragmente:

a. Prej minutës 04'43'

HF: Po, po. Desha t'u bëj një pyetje: Kto meloditë bizantine, a ke ndigju gjo? Ç'a ishin kto? Ndonjë gjë kot, për t'i shiju, për shembull, çik më shumë. Ndonjë fjalë ke ndigju për kto, ç'a ishin, si ishin trashëgu k'to? Nga vijshin kto? Ç'ishin këto melodi?

TD: <Bilahi> kan' qenë ashtu lavdërojshin ato... Lavdërim Perëndie, qysh themi? Perëndia <...>. Lavdërima të shejtorëvet. I këndojshin shenjtorëvet. Do me thënë melodia, një tekst për Shën Kollin, për shembull. Teksti fillonte sikur të ishte dita e këtij. Se ata shenjtorët që ishte kisha, që i lavdëronte. Se shenjtorët e asaj kohe quheshin si dëshmorë të kishës.

HF: Po. E kuptoj.

TD: E kuptoni ju atë. Si ka qenë në atë kohë; ashtu ishte koha i asaj. E gjithë meloditë kishin tekste të shenjtorëve të perëndisë. O zot, o zot, lavdëro perëndinë, ku di unë ksi gjërash kshu. Lavdërima për perëndinë, për hyjninë.

HF: Për shejtorët, po.

TD: Për shejtorët. (.)

HF: Mirë. (.)

TD: Ishin krejt kishtarë. Krejt fetare.

b. Prej minutës 06'47'

TD: Kur u ndanë kishat, të flasim pak me histori. Kur u ndanë kishat në shekullin IX, më duket që u ndanë kishat n'ato kohë...

HF: Me urdhëresat e Martin Luterit.

TD: Luterit, asi kohe. Jo, më fal, se Martin Luteri protestoi atë katolicizmin, kishën katolike. Po kur u ndanë se qe Kisha Lindjes. Kisha orthodoxe quhet Kisha e Lindjes, se u kriju prej Bizantëvet. Natyrisht Bizanti është Lindja. Edhe Stambolli. Azia, si i thonë asaj Lindja.

HF: Kostandinopoli.

TD: Edhe u ban' dy kryeqendra. Do me thënë kryeqendra e Bizantit, kishës së Bizantit, edhe e Romës.

HF: Perandoria romake.

TD: Mirëpo perandoria romake, që kur u ndanë, nuk mbaj mend mirë, po më duket më 909, jo në shek. XIX më ngjan u ndan.

HF: Nejse më përparshëm.

TD: Nuk e di, s'e mbaj mend mir'. Sa mbaj mend. Se i harroj unë. Qe desha t'thom? Harrova.

Ë...

HF: Kur u ndanë.

TD: U ndanë atëhere ato edhe kisha e Romës mbajti më tepër si gja, e modernizoi atë tingullin, ato muzikën. Edhe kisha e Romës deri së fundi, imë, bante vegla muzike n'kish, kurse kisha orthodoxe s'ka pas pranu.

HF: I ka rujt më origjinale.

TD: Më origjinale.

HF: Ortodokse.

TD: Bizantinën. Atë tjetrën e ka më shumë. Ajo rujte, edhe ajo deri më sot e ka. Megjithëse disa kisha autoqefale tjera kanë fillu me e modifiku, me u ba kshu.

HF: Ajo nuk ka pranë.

TD: S'pat pranë; ka qenë më ashu, nuk pranonte ashu. Ajo kishte,

SM: Ma drejt, ma drejt.

TD: Ma ashu rregull. Jan' t'gjith me gojë.

HF: Pa shoqërim?

TD: Pa shoqërim.

HF: Interesante <...>.

TD: (.) Edhe ne asistojshim neve nëpër ato vende, kishim ato psalltet. Psallt quhesh, ashtu thuhej. Sikurse janë ato psallmet e Davidit, që është ajo profiti David, mund ta dini atë Bibllën që është, edhe ajo si bahet edhe këtë ka pas vazhdu deri më së fundi, sidomos neve këtu. Kshu kemi pas. Se këtu pastaj në dioqezën e Elbasanit, se si Dioqezë, asi kohe, quhesh Durrës, ishin gjithë këto, do me thënë, Durrës, Kavajë, Tiranë, Peqin se ishin të krishterë m'ato kohë, të gjithë. Edhe kishte një dioqezë të gjatë deri, do me thënë, kryt ishte në Durrës, edhe Gora. Durrës e Gorë. E ishin ato piskopët. M'ato kohë t'vjetra patën qëllu disa episkopë këtu që, thotë gojëdhëna, që ishin muzikantë të fortë. Edhe qendrën e kishin si dioqezë, e kishin gjithnji në Elbasan, se Elbasani ishte në mes:-

b. Prej minutës 14'20'

TD: Vinte ai, ka qenë ai muzikanti i asaj kohe, kohë të moçme.

HF: Kukuzeli

TD: Sipas kohës të, sipas Bibllës që është ajo, Davidi që i thonë turqisht Daut. Ai ka pas ba ato tekstet e atij,

HF: Tekstet e atij?

TD: Po ka. Shumë tekste janë të atij, ma tepër. Që është ajo Psallma e Davidit, në qoftë se e din' atë Bibllën që është ashu. Ato pendimet e Davidit, e ku di unë ç'kan' qenë ato.

HF: Kanë qenë të thjeshta.

TD: Hm, ka pas hem ashtu, hem ashtu. (.)Po të gjitha me zot e me perëndi janë.

HF: Ashtu janë. Në kishë janë këndu. Sigurisht ashtu janë.

TD: S'kam as fuqi.

HF: Pak, lehtë. Shumë lehtëshëm

TD: (.) [Këndon]

O zot thirra ke ti dëgjomë, o Zot. [Psalmi 140. Këndohet në Mbrëmësore].

Se ajo psalma ka pas qenë kështu me iso prapa: "O".

SM: E baj unë. Ti ec. [Mban pak iso Stefan Marku në fillim]

TD: *O zot thirra ke ti, dëgjomë/Vër re zanin e lutjes sime/Dëgjomë o Zot./ Le të vij falja ime, përpara teje, o Zot, dhe ngritja e duarve t'mia si therore, o Zot.*

Mastaj, muzika kishtare ka pas ato tingujt, zanat, sikurse muzika moderne. Do me thënë, muzika kishtare ka pas tetë ashtu, pa, vu, ga, dhi, qe, zo, ni, pa [bëhet fjalë për notat e muzikës bizantine]. Tetë, njëkohësisht edhe moderne m'rri sikur i ka kshu. Ë... Do, re, mi, fa, sol, la, si, do. Pastaj kishin ato dredhjet e veta këto. E para dridhesh me gjysëm zëni, me ku di unë sesi. Si i thoni juve me ifes e me difes [greqisht për bemol dhe diezis], s'i mbaj mend ashtu, po, me këto, me anë të këtyne përmbledhshin gjith këto, që i përdridhje, i drejtoje.

SM: <...>

TD: Edhe më tepër i thoshin përmendësh. Se kshu i mësojshim ma tepër. Ishin edhe ato kshu, po i mësojshim përmendësh pastaj. Ku di gjo. Ky qe zani i parë që mora³², pastaj kishte zë të dytë, zë të tretë, zë, zënin e dytë.

HF: Tashi do ta marrim zërin e dytë?

TD: Po <...>

HF: Po mirë, ky ishte zani i parë.

TD: Po edhe zëni i parë, kishte edhe përkthime ashtu, qysh tua tregoj, me rry

d. Prej minutës 22'58'

TD: Po s'kishe vesh, s'kishe gjë hiç fare. Humte. Prishte ujdj, se përziheshin. Vinte nji, se ishte me dëshirë ajo, se nuk paguheshin. Vijshin qejfli. Se ishte muzikë ajo. Futeshe ndonji ashtu dhe thoshim: "Aman me leje ti njiherë, se na prishe punë".

Sikurse me këngët e vjetra të Elbasanit, që kemi pas këndu ne. Kurdoherë ato ishin me vesh të gjithë. Se po s'ishin me vesh, o!

HF: Del ndonjëni s'din me këndu. <...>

TD: Nuk ka vesh, jo nuk a puna me knu. E prish.

SM: Kshu edhe Taqi at'kohë. Shumë njerëz e ndihmonin, por ky i përzinte. <...>

32 Zani i parë, sipas muzikës bizantine nënkupton Tingullin e Parë.

TD: Qe ky. I thosha hajde, se kishte vesh ky. Stefani, ka pas vesh ky.

HF: Po mir, Stefan, iso mbahesh gjithmonë "i", notë e gjatë, s'kishte kshu me shqiptim fjalësh, nuk shqiptonte.

TD: Jo. N'atë pjesën e fundit. Duhet të dinte një çikë atë. [Merr tingullin]

HF: Të dinte bazën.

TQ: Bazën. Rrinte një minutë ky tjetri pushim, po tingulli vazhdonte.

HF: Tingulli i isos?

SM: Isos.

TD: Se këndimet kishtare kështu kan' qenë. Jo të këputësh. Të marrësh frymë ti e ta këputësh. Jo.

HF: Këndonte tjetri, ison.

TD: Muzika nuk këputet, po mos marrë fund. Se ai psallti që këndon, nuk do ta,

HF: Sot, për shembull, ne kemi fshatarët, kur këndojnë, kanë një këputje, këndojnë vargun, katër vargje, 2 vargje, pastaj vap, pushon dhe iso. Pastaj hyn e ia merr prapë nga fillimi, vazhdon.

TD: Po, po.

SM: Po mbajti frymë ai kryetari i melodisë, isoja gjithnji vazhdon.

TD: Jo heshtje, sa të mbaroj ajo pjesë. Se kisha e ka pas kshu zakonin. Ishte psallti. [Kollitet]. Ishte edhe prifti. Do me thënë as prifti pa psalltin, as psallti pa prift. Për nevojë, ndonjë psallt do bënte edhe vetë, se nevoja ka të baj. Po shkojshin paralel. Do me thënë, e mbaronte psallti këngën, e dinte, se kuptojshin me shoshoqin. E merrte prifti atje pjesën që kishte ai. Mbaronte prifti derisa të mbarohesh kisha. Nuk kishte ndalesa. Që të rrijnë pesë minuta rehat fare.

SM: Vazhdueshëm muzika.

TD: Kshu ka qen'. Daç shkonte si të ishte puna. Shkonte një orë vazhdonte, a gjysëm ore, dy orë, si të ishte melodia. Si t'ishte puna. Sa të ishte kisha çel, një veprim do vazhdonte. Mbaroi kisha, asgjë. (.) Jo këputje.

SM: Lumi i Jordanit.

TD: M?

SM: <...> Lumi i Jordanit [Këndon.]

TD: [Këndon]

Në Jordan kur pagëzohesh ti o Zot/ Falja e Trinisë u shfaq/ Dhe zani i prindit të dëgjonte birin e tij të dashur dyke kujtuar/ Dhe shpirti i shenjt në formë pëllumbi e siguronte vërtetësinë e fjalës/ [Kollitet] Ti që u ngrite, Krisht Perëndi dhe ndriçove botën lavdi më ty.

[Përlëshorja e festës së Ujit të bekuar, përkthimi i Nolit]

Të gjitha këto, kto dy-tri që kam këndu hyjnë në tingullin e parë. Po në tingullin e parë kish një ndryshim kështu, sa andej këtej, qysh ta tregoj". <...> Po në tingullin e parë.

[Fërshëllen]

Engjëlli thërriste me (.)

Engjëlli thërriste Hyjlindëse, gëzoju Hyjlindëse, se biri yt u ngjall pas tri ditësh prej varrit. Ndriçohu, o Jerusalem i ri, se prej teje lindi Krishti perëndia jonë që i fali botës përdëllimin e madh [Kënga /Oda IX e Shërbesës së Ngjalljes].

Ja kshu. Ca ishin me trajtë më të shpejtë, ca baheshin ma të shkurtër, kështu. Si të ishte koha. Po kto ishin kështu, do me thënë, ishin brenda të një tingulli, po kishin ato të përkthieme, si kshu.

HF: Secili za, kishte të vetën.

TD: Kishte të vetën. Kishte një ashu,

SM: Ka një diçka këtu bre Taqi. [Këndon me gojë mbyllur]

TD: [Këndon]

<...>

Gëzohu Hyjlindëse, se biri yt u ngjall pas tri ditësh prej varrit. Ndriçohu.

Nji kjo "o" që banim ne, hyn në tingull tjetër.

Ndriçohu o Jerusalem i ri, se lavdi e Zotit lindi përmbi ty.

Gëzohu o Hirplotë. Se prej teje, lindi.

HF: Të lumtë goja!

TD: Ai e mbante <...> Se psallti, kur e harronte nganjëhere, s'e gjinte, ato do mbajshin po iso. Ene ipte nga një si kohë sa ta gjinte, po në një mënyrë që ai ta qiste atë, po mos humbesh puna, aty ishte ajo teknika. Mos dëgjonte populli se bahesh <hazmalli>!

HF: Se ishte vend i shenjtë.

TD: Jo për i shenjtë, por prisheshe ajo melodia, prishej bukuria. Për ktë baheshin kto. Duhej të kuptoheshin, prandaj zgjidheshin. Po të ishte një ashtu, i thoshim,

SM: Pe dë syz?

TD: I thoshim ne "pe dë syz" kështu i thoshim, pa perde. Syz është hamdi, turqisht. Pe dë syz, do me thënë, pa melodi.

Një tjetër aspekt që u evidentua kishte të bënte me detajet e regjistrimit, ndërprerje të caktuara, dhe, gjithashtu, tonet ndryshme të ligjërit të dy protagonistëve kryesorë: Filjas dhe Delianës.

Në këtë fazë të dytë, në të cilën teksti i shkruar iu pranëvu "tekstit" të parë, mund të reflektohej më sistematikisht rreth asaj çka mund të kapë ose jo një regjistrim i caktuar (inscription) dhe çfarë mund të zbulojë ose jo një transkriptim caktuar.³³ Në rastin kapjes, vërehet që prozë-biseda ka disa ndërprerje gjatë ecurisë së saj; pra, ky material i mediatizuar nuk e ka kapur të plotë, në gjithë shtjellimin e vet ngjarjen. Për shembull, fakti që biseda fillon direkt me Delianën që është duke folur, lë të nënkuptosh që prezantimet paraprake, stadi i parë i njohjes mes tyre ishte zhvilluar,

33 A. Duranti, *Transcripts, like shadows on a wall*, 306.

pa u fiksuar në shirit. Që këtu përballemi me natyrën përzgjedhëse të këtij regjistrimi. Vendimi për të shtypur butonin e regjistrimit në një çast të caktuar, përbën në vetvete një akt vendimmarrës, sado i qëllimshëm apo jo.

Në vijim, hyrja e intervistës:

TD: dy-tri tjera të mëhallës tonë, ktu t'mëhallës së kalas' i çum n'shköllë shqipe.

HF: Kush ishte ajo pjesa të lutem me Kristoforidhin?

TD: Gruja ime.

HF: <Gruaja ishte mbesa e Kristoforidhit>

TD: E motra e atij Kov msusit. Asht një Kov Bibaja, në qoftë se e njëfni. Nejse. Nji ime motër që ka vdekë, ajo grua teme që është gjallë, një dy-tri të tjera, harroj kush janë ato, të mëhallës tonë, gjallë janë ato. M'duket sikur Dhoksia e Shites, m'ngjan. Ajo m'ngjan Dhoksia. E du t'them që i patëm çu në shkollë shqipe në Korçë, që u hap për herën e parë m'ato kohë që qen ajo Parasqevi Qiriazhi me shokë, mund t'i dini ju ato.

HF: Posi, posi.

TD: E du t'them, kaqe sa mbaj mend. Edhe kshu ra në kundërshtim me politikën kishtarë greke të asaj kohje. Ra në kundërshtim. E hoqën babën tem. Du t'them që pat, qe luft'e madhe për at' kohë. Për sot nuk asht gj, por tuj mendu atë kohë as'here, kemi ba luftë shumë, do me than, për dëshirë pune, qysh thujsh mor atëherë.

HF: Për të rujt gjuhën.

TD: Për të rujt gjuhën. Sikurse thash' edhe Noli, do me thënë, herën e parë, librat e Nolit janë ato. Se Nolin mund ta qujsh me gjithë qejf themeltar ose ai që e bani kishën autoqefale. Edhe kshu ka vazhdu kisha, me kto hymne, me ato që kishin.

HF: Përpara Nolit, para se të vinin librat e Nolit, me ato përkthimet fetare, në gjuhën shqip që ju that', këndonit meloditë bizantine apo jo?

TD: Po këndojsim.

HF: Përpara këndojsht, por greqisht.

TD: Gjithsej greqisht, po kishte ca që kishin mundësi që i,

HF: Këndojshtin shqip.

TD: Që i këndojshtin; i përkthejshtin se nuk ishin të shtypyna.

HF: A, i përkthejshtin.

TD: Po zotëronte gjuhën greqisht ai, se kishte ba një shkoll', duke e pa, e përkthente. Si psalltë që thona ne. Psalltë.

HF: I përkthente

TD: Nji nga ata, që përkthente m'ato kohëra q'ish i zoti, e kish at' zotësi ashu, ka qenë edhe ky, i ati, po, i grus teme. Ka qenë Mim Teneqexhiu, i ati i Povit, Mim Bibaja. Ka qenë psallt i mirë.

HF: Para 1908.

TD: Përpara, biles ai ka vdek '900 e... ku di unë, s'mbaj mend. Përpara 1908. Edhe di ca pak nja ashtu sende. Edhe Ungjilli n'ato kohë, po n'lagje tonë, e drejta, ka pas, me të vërtetë, jo ashu, po ka pas ndjeja e shqiptarizmit mbahet ashtu. Shqiptarizmit në atë mënyrë që të këndohet gjuha shqip që ta kuptojnë. Thuhesh Ungjilli ashu tek-tuk, edhe një që thoshin, n'atë kohë ishte nga priftat më të vjetë të asaj kohe, ishte baba tem. Edhe ai e thoshte Ungjillin shqip, e ku di unë. Ka qenë kjo rrymë, kjo dëshirë ka qenë.

HF: Baba juj ka qenë, nënë... Çka qenë në atë kohë?

TD: Prift, i lagjes së Kalas'.

HF: Prift i lagjes Kala?

TD: I lagjes Kala. Po ka qenë edhe zëvendës episkopi.

HF: Zëvendës episkopi?

TD: Po këtu. Po në lagjen Kala ka qenë. Edhe kshu ra n'kundërshtim me atë. E hoqën nga puna.

HF: Po. Si e kishte emrin babai yt?

TD: Ee...Papa, se Papa dmth prift, e kuptoni? Papa Veniamin.

HF: Kurse juve si e keni ju?

TD: Taqi Deliana. Llagapin Deliana. Papa Veniamin Deliana. Psallte shqip në kishë, bante shqip edhe një kohësisht, sikurse thash, pat çue vajzën e vet në shkollë pat çu ashtu. Ra n'kundërshtim me politikën greke sa që ai i thoshte dhespoti: "Hiqe vajzën, hiqe prej shkolle e kshu". Ai thoshte: "Po ç'a t'i bëj unë tashi? Ajo hyni atje. Ra n'kundërshtim. Erdh lufta ballkanike, erdhën luftat më 1912. U prish ajo shkollë. Shkolla që ishte Parasqevi Qiriazhi.

HF: Po, po. Desha t'u bëj një pyetje: Kto meloditë bizantine, a ke ndigju gjo? Ç'a ishin kto? Ndonjë gjë kot, për t'i shiju, për shembull, çik më shumë. Ndonjë fjalë ke ndigju për kto, ç'a ishin, si ishin trashëgu k'to? Nga vijshin kto? Ç'ishin këto melodi?

TD: <Bilahi> kan' qenë ashtu lavdërojshin ato... Lavdërim Perëndie, qysh themi? Perëndia <...>. Lavdërima të shejtorëvet. I këndoishin shenjtorëvet. Do me thënë melodia, një tekst për Shën Kollin, për shembull. Teksti fillonte sikur të ishte dita e këtij. Se ata shenjtorët që ishte kisha, që i lavdëronte. Se shenjtorët e asaj kohe quheshin si dëshmorë të kishës.

HF: Po. E kuptoj.

TD: E kuptoni ju atë. Si ka qenë në atë kohë; ashtu ishte koha i asaj. E gjithë meloditë kishin tekste të shenjtorëve të perëndisë. O zot, o zot, lavdëro perëndinë, ku di unë ksi gjërash kshu. Lavdërimë për perëndinë, për hyjninë.

HF: Për shejtorët, po.

TD: Për shejtorët. (.)

HF: Mirë. (.)

Nga ana tjetër, ky material të jep mundësinë sot që të analizosh dhe të interpretosh dinamikat e një marrëdhënieje mes një interpretuesi/informanti që regjistrohet dhe studiuesit që regjistron në një kontekst të caktuar. Nga kjo pikëpamje, ajo çka mund të zbulojë ose jo transkriptimi ka të bëjë para së gjithash me ndërgjegjësimin për vendin e transkriptuesit brenda procesit, rolit që ai/ajo ka në shpalosjen e tij, në përfaqësimin e folësve, ligjërata e të cilëve është transkriptuar. Mary Bucholz e quan këtë «praktikë refleksive transkriptimi», në të cilën kërkuesi nuk “zhduket” por qëndron vigjilent dhe i ndërgjegjshëm për rolin e tij, qoftë në shtjellimin e transkriptimit, ashtu edhe në efektin që ka procesi në përfaqësimin e folësve ligjërata e të cilëve po transkribohet.³⁴ Rasti im është ai i një dëgjueseje dhe transkriptueseje të jashtme të kësaj prozë-bisede dhe jo i një protagonisteje të saj. Duke mos qenë e pranishme “aty”, në çastin kur ndodh ngjarja, unë nuk zotëroj informacion rreth atij konteksti, siç mund të kishte Hysen Filja nëse do ta kishte transkriptuar. Nga ana tjetër, unë kam hulumtuar kontekstin studimor, historik dhe kulturor brenda të cilit është shtjelluar kjo prozë-bisedë. Familjariteti me protagonistët e këtyre ekspeditave më dha mundësinë të njihja personat e tjerë pjesëmarrës, ndër të cilët, do veçoja figurën e Stefan Markut, i cili ndonëse nuk është qendror në regjistrim, luan një rol të rëndësishëm në dinamikat e kësaj bisede, sikundër është një ndër pikat e referimit për studiuesit që shkojnë në Elbasan me ekspedita nga vitet '60 deri në fund të viteve '80-të; pra, përgjatë 30 viteve. Një tjetër veçori e punës sime është edhe distanca kohore nga ngjarja, konteksti tërësisht i ndryshëm politik dhe social-kulturor në të cilin unë veproj si studiuese dhe, sigurisht, qasja teorike e interpretive që përpiqem t'i jap ngjarjes tingullore dhe asaj të shkruar.

Ndërgjegjësimi për të gjitha këto detaje ka të bëjë me «konceptin e të vepruarit në mënyrë adekuate»³⁵, sa i takon vlerësimit adekuat dhe drejtpeshimit që i duhet bërë një lloj transkriptimi përkundrajt një tjetri - duke pranuar shumësinë e metodave e qasjeve që mund të ekzistojnë ndaj tij dhe duke arsyetuar se për çfarë është i nevojshëm ky transkriptim dhe çfarë qëllimesh synon të arrijë.

Nga protagonistët e këtij regjistrimi, ishte gjallë vetëm Miranda Dule, e cila ishte folkloriste në profesion dhe në ekspedita mbulonte pjesën e folklorit letrar. Ajo ka shumë pak ndërhyrje në bisedë. Gjithsesi, e kontaktova në lidhje me mundësinë e dhënies së ndonjë informacioni lidhur me të. Për shkak të distancës së largët kohore dhe shkëputjes së saj nga ky profil

34 M. Bucholz, *The politics of transcription*, 1461, 1462.

35 A. Duranti, *Transcripts, like shadows on a wall*, 306-307.

pune studimore qysh në fillim të viteve '80, ajo nuk mbante mend detaje të kësaj bisede, madje nuk kishte kujtesë fare për zhvillimin e saj. Krahas tyre, kemi edhe argumentet e Eno Koços, i cili është gjithashtu dëgjues reflektues i kësaj bisede. Megjithatë, një pjesë të komenteve të Koços do të duhet t'i marrim me rezervë, nëse i referohemi të dhënave të dokumentit. Së pari, nuk mund të pohojmë që regjistrimi është bërë nga Deliana, pasi në bisedë del qartë se kush e realizon bisedën, kë institucion përfaqësonte dhe cilat qëllime shpallte aty për këtë. Nuk kemi të dhëna të dokumentuara për kontributin e muzikologut Albert Paparisto në organizimin e kësaj bisede dhe interesin specifik të tij për të regjistruar Delianën. Po ashtu, Albert Paparisto nuk ka botuar, në dijeninë time, material studimor lidhur me praktikat muzikore fetare të lagjes Kala të Elbasanit. Puna e Filjes me muzikën e Shqipërisë së Mesme është më e përligjur për ta justifikuar këtë dhe mund të supozojmë se Albert Paparisto, lindur në Elbasan dhe pinjoll i një familjeje të njohur të lagjes Kala mund të ketë dhënë kontribut në këtë drejtim. Të njëjtën rezervë mund të themi edhe lidhur me ndihmesën që mund të ketë dhënë prejardhja muslimane e Filjes në realizimin e bisedës. Kurse, sa i takon kurajos dhe dëshirës, kjo është diçka që karakterizohet nga një tension i brendshëm e i vazhdueshëm sidomos nga ana e Delianës dhe që reflektohet edhe konkretisht në një moment të caktuar të intervistës:

(min: 12'38')

HF: Tashti xha Taqi³⁶, shplodhu i çik dhe na intereson një çik psh, duke fillu nga ato, sa të kesh mundësi, meloditë më të thjeshta që i bëjshit në kish' ju që këndonit ato shejtorët.

TD: Po të gjith këto ishin kështu, kishtare ishin. HF: Epo nga ato dum, ne nga ato sigurisht. Nga ato më të thjeshtat deri ke ajo që ju mund të mendoni që, është një çik më e vështirë. Pra do na interesonte shumë, apo jo, që të fillojshim nga ato më të shkurtat, më të thjeshtat.

TD: As i mbaj mend mirë.

HF: Mendohu njëherë e pastaj fillojmë. Mendohu një herë, shplodhu njëherë. Pra duke fillu nga ajo më e thjeshta që mund të kish një përjetim shumë të thjeshtë teknikisht; një melodi ndoshta 8-masash, ju e dini më mir' se ne, s'e dim, e duke fillu një çik me ato më të avancimet. Shplodhu njëherë.

SM: Kujtoju.

TD: **Mos jetë një inçizim që të dali përjasht?** [theksimi im]

HF: Nuk del ajo, Edhe me dash ne, nuk del, apo jo? Vetëm për të studiu siç

36 Dëgjojmë që Filja i drejtohet Delianës si xha Taqi, në një rast, më poshtë edhe dajë Taqi. Mund të themi se kjo është një mënyrë për të krijuar afritet dhe familjaritet me të, për ta "rehatuar", le të themi, në bisedë. Pavarësisht këtij toni afektiv, muret ndarëse mes subjektit që regjistrohet dhe atyre që regjistrojnë ngelen gjithmonë të pranishme.

shërben si histori.

TD: Në rregull. Se thash, dmth.

HF: Jo, jo. Asesi. Edhe me dash nuk ke, apo jo. Edhe me dash ne, s'të le njeri. <...>

TD: Prandaj unë më parë i thash'edhe Stefanit se nuk i shërbejnë njeriu këto, kto janë gjëra për ant-,

MD: Kto janë historike.

TD: Historike. Për antikitet

HF: Ne na interesojnë vetëm nga ana melodioze. Për atë mos ke merak ti.

SM: <...>

TD: Jo se jana gjana si, qysh se u ban... Qysh themi ma, ju e kuptoni vetë.

HF: Hiç mos ke merak.

TD: (.) Plaku do gjithmonë të jetë në rregull për çdo gjë. Edhe i riu po sidomos.

HF: Na ndihmon vërtet, na ndihmon

Në tërësi, biseda karakterizohet nga një shumësi gjendjesh të Delianës: frika, presioni ndaj pushtetit të regjistruesve, pasiguria, por edhe presioni që i bën Filja dhe të tjerët me justifikimin që këto gjëra janë vetëm për arkiv dhe nuk dalin kund; po ashtu, bindja, rezerva dhe kujdesi i vazhdueshëm që ai mban gjatë gjithë kohës në dhënien e përgjigjeve.

IV. Përfundime

Regjistrimi në letër i një akti ligjërimitor të folur, por edhe të kënduar, përmes transkriptimit nuk është një proces neutral, por një praktikë kulturore e cila ka nevojë të jetë e mbrujtur me një qasje kritike. Kjo vlen qoftë kur flasim për kontekstin akademik, me dokumente zanore, mbledhje intervistash apo bisedash etnografike, qoftë edhe në nivele jashtë botës akademike, si mund të jetë fusha e gazetarisë. Një rast studimi si prozë-biseda me Taqi Delianën tregon qartësisht nevojën për një metodologji e teori pune, e cila të mund të bëjë një përfaqësim të caktuar të ngjarjes. Edhe pse ky është një përfaqësim i pjesshëm, si tregon Duranti, duke u tematizuar na lejon të analizojmë me kujdes shtresëzimet e shumta kulturore me të cilat procesi është mbrujtur, lidhjet që formohen mes protagonistëve të përfshirë dhe po aq mes dokumentit në vetvete, rrethanave historike në të cilat është realizuar dhe transkriptuesit. Ndërgjegjësimi për këto lidhje formëson përvojën dëgjimore, atë përvojë që ndërmjetëson regjistrimin e tij në letër dhe analizën konkrete të rezultateve; dhe, njëherazi, kjo përvojë lë të hapur mundësinë edhe për shtigje të reja shqyrtimi të dokumentit në fjalë, në të ardhmen.

BIBLIOGRAFIA

- Ballgjati Edmir, *Ahengu shkodran. Notizim i plotë*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2021
- Bardhoshi Nebi dhe Olsi Lelaj, *Etnografi në diktaturë: Dija, shteti dhe holokausti ynë*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2018.
- Barthes Roland, *Le grain de la voix*. Paris: Seuil, 1981
- Bauman Richard dhe Charles L. Briggs, *Voices of Modernity. Language Ideologies and the Politics of Inequality*, Cambridge University Press, New York, 2003.
- Bevapi Kujtim, *Shoqëria 'Afërdita'*, në Kujtim Bevapi (përg.) *Elbasani Enciklopedi*, Sejko, Elbasan, 2003, 558-559.
- Bucholz Mary, *The politics of transcription*, "Journal of Pragmatics" 32, (2000), 1439-1465.
- Cécile B. Vigouroux, *Trans-scription as a social activity: An ethnographic approach*, "Ethnography" 8/1 (2007), 61-97.
- Deliana Rudolf dhe Rudina Deljana, *Vasil Andoni*, Instituti Lumo Skendo, Tiranë, 2018.
- Duranti, Alessandro, *Transcripts, like shadows on a wall*, "Mind, culture, and activity" 13/4 (2006), 301-310.
- Erlmann Veit, *Hearing cultures. Essay on sound, listening and modernity*, Berg, Oxford; New York: 2004;
- Erlmann Veit, *Reason and resonance: A history of modern aurality*, Zone Books, New York, 2010.
- Filja Hysen, *Këngë popullore të Shqipërisë së mesme*, Akademia e Shkencave e RPS, Tiranë, 1991
- Ingold Tim, *Lines: A Brief History*, Routledge, London, 2007
- J. H. Stelma dhe L. J. Cameron, *Intonation units in spoken interaction: Developing transcription skills*, "Text & Talk" 27/3 (2007), 361-365;
- Jaffe Alexandra, *Variability in transcription and the complexities of representation, authority and voice*, "Discourse Studies", Vol. 9, No. 6 (2007), 831-836.
- Kaçiu, Ervin, *Projekti kërkimor: Atlasi etnografik i fshatit sot. "Antropologji"* 5/1 (2022), 133-136.
- Koço Eno, *Udhëtim i isos vokale/A journey of the vocal ison*, Neraida, Tiranë, 2014.
- Kumbe Meri, *The psaltic art in Albania from the beginning of the 20th century until today*, Tezë doktorature. Universiteti Kombëtar "Kapodistria" i Athinës, Dega e Studimeve Muzikore, Athinë, 2018.
- Minga Mikaela, *Tinguj që rrëfejnë, tinguj që rrëfehen – Elbasani në regjistrimet etnomuzikologjike të arkivit audiovizual – IAKSA*,

- Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2020.
- Ochoa Gautier, Maria. *Aurality: Listening and knowledge in nineteenth century Colombia*, Duke University Press Durham, NC, 2014.
- Ochs, Elinor, *Transcription as theory*, në E. Ochs & B. Schieffelin (përg.) *Developmental pragmatics*, Academic, New York, 1979, 43-72.
- Rice Timothy, *Ethnomusicological theory*, "Yearbook for traditional music" 42 (2010), 100-134.
- Rice Timothy, *Modeling ethnomusicology*, Oxford University Press, Oxford, 2017
- Stelma Juurd H. dhe Lynne J. Cameron, *Intonation units in spoken interaction: Developing transcription skills*, "Text & Talk" 27/3 (2007), 361-365.
- Szendy Peter, *Listen: A history of our ears*, Fordham University Press, New York, 2008.
- Vigouroux Cécile B., *The making of a scription: a case study on authority and authorship*, "Text & Talk" 29/5 (2009), 615-637.